



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02/R

Prokurorja e Specializuar k. Salih Mustafës

Vendosi: Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm

Gjykatës Zhilber Biti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mustafës për Pezullim të Përkohshëm dhe Çështje të Tjera

T'i dorëzohet:

Mbrojtjes së Viktimave
Ani Puz

Mbrojtësit kujdestar të Salih Mustafës
Laurens van Pajenbruk

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

GJYKATËSI I VETËM¹ lëshon këtë vendim mbi Kërkesën e Mustafës për Pezullim të Përkohshëm dhe çështje të tjera.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses I lëshoi urdhrin për zhdëmtim kundër Salih Mustafës (përkatësisht, Urdhri për Zhdëmtim dhe z. Mustafa), ku urdhëronte z. Mustafa t'u paguante zhdëmtim tetë (8) viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor, si kompensim për dëmin e shkaktuar. Trupi Gjykses vendosi që zhdëmtimet duheshin paguar brenda afatit që do të caktohej nga autoriteti gjyqësor që do të caktohej për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, për të garantuar proces efikas dhe të shpejtë për hir të viktimave si dhe ftoi Kryetaren e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) të caktonte këtë autoritet.² Urdhri për Zhdëmtim nuk u apelua as nga z. Mustafa dhe as nga mbrojtësja e viktimave.

2. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit konfirmoi të gjitha vendimet e fajësisë, të cilat përbënë bazën e Urdhrit për Zhdëmtim.³

3. Më 3 janar 2024, Administratorja caktoi Venkatesvari Alagendrën (znj. Alagendra) si mbrojtëse të z. Mustafa, në vend të Julius von Bone.⁴

¹ KSC-CA-2023-02/R, R001/F00001, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, [Decision Assigning a Single Judge](#), (Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm) 17 janar 2024, publik, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00517, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës*, 6 prill 2023, konfidencial, para. 250-252, 283, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i korrigjuar u lëshua më 14 prill 2023, [F00517/RED/COR](#).

³ KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Appeal Judgment](#), (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit) 14 dhjetor 2023, para.481.

⁴ KSC-CA-2023-02, F00041, Administratorja, *Njoftim i Miratimit të Mbrojtësit të Salih Mustafës*, 11 janar 2024, publik, para. 4, me Shtojcën 1, konfidenciale.

4. Më 17 janar 2024, Kryetarja e DHSK-së caktoi gjykatësin Zhilber Biti si Gjykatës të Vetëm për të mbikëqyrur zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim.⁵
5. Më 19 janar 2024, Mbrojtësja e Viktimave i kërkoi Gjykatësit të Vetëm t'i caktonte z. Mustafa një afat për pagimin e zhdëmtimeve të akorduara për viktimat (Kërkesa e Mbrojtëses së Viktimave).⁶
6. Më 22 janar 2024, Mbrojtja e z. Mustafa ("Mbrojtja") i kërkoi Gjykatësit të Vetëm të pezullonte përkohësisht caktimin e këtij afati deri pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë para Panelit të Dhomës së Gjykatës Supreme të DHS-së, ose vendimit përfundimtar në lidhje me të ("Kërkesa e Mbrojtjes").⁷ Mbrojtësja e viktimave u përgjigj më 23 janar 2024.⁸
7. Më 25 janar 2024, Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme u shpreh se emërimi i znj. Alagendra nuk kishte fuqi ligjore⁹ dhe se ajo nuk kishte të drejtë ligjore të parashtronte kërkesa në emër të z. Mustafa,¹⁰ meqenëse njëkohësisht përfaqësonte Jakup Krasniqin ("z. Krasniqi") në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve* (KSC-BC-2020-06) para Trupit Gjykues II¹¹ dhe nuk i kishte kërkuar Trupit Gjykues II të merrte vendim nëse ekzistonte konflikt interesash.

⁵ *Shih* poshtëshënimin 1 më lart.

⁶ KSC-CA-2023-02/R, R001/F00002, Mbrojtësja e Viktimave, *Kërkesë për Caktimin e Datës për Pagimin e Zhdëmtimeve*, 19 janar 2024, konfidenciale, para. 8.

⁷ KSC-CA-2023-02/R, R001/F00003, Mbrojtësja e Viktimave, *Kërkesë e Mustafës për Pezullim të Përkohshëm*, 22 janar 2024, publik, para. 1, 4, 9.

⁸ KSC-CA-2023-02/R, R001/F00004, Mbrojtësja e Viktimave, *Përgjigje e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës së Mustafës për Pezullim të Përkohshëm*, 23 janar 2024, publike.

⁹ KSC-SC-2024-02, F00008, Paneli i Gjykatës Supreme, [Decision on Prosecution Motion Regarding Conflict of Interest of Defence Counsel](#), (Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Konflikt Interesash të Mbrojtësit), 25 janar 2024, publik, para. 9, 11.

¹⁰ KSC-SC-2024-02, F00009, Paneli i Gjykatës Supreme, [Decision on the Request for an Extension of Time](#), (Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit), 25 janar 2024, publik, para. 11.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00058, Administratorja, *Njoftim për Emërimin e Mbrojtësit për Jakup Krasniqin*, 6 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

8. Më 29 janar 2024, Administratorja informoi Gjykatësin e Vetëm për caktimin e Laurens van Pajenbruk ("z. Pajenbruk") si mbrojtës kujdestar të z. Mustafa.¹²

9. Më 8 shkurt 2024, Trupi Gjykues II konstatoi se "[do të ekzistonte] mundësi për konflikt interesash në qoftë se, krahas emërimit si mbrojtëse e z. Krasniqi, znj. Alagendra do të përfaqësonte edhe z. Mustafa".¹³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Gjykatësi i Vetëm mbështetet në rregullat 9(5)(a), 24 dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja) dhe nenin 21(2) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara).¹⁴

III. ANALIZË

A. KËRKESA E MBROJTJES

11. Duke mbajtur parasysh vendimin e Panelit e Dhomës së Gjykatës Supreme se emërimi i znj. Alagendra nuk kishte fuqi ligjore dhe se ajo nuk kishte të drejtë të parashtronte kërkesa në emër të z. Mustafa,¹⁵ Gjykatësi i Vetëm rrëzon Kërkesën e Mbrojtjes *in limine*, për të njëjtat arsye dhe nuk do ta shqyrtojë më tej.

¹² KSC-BC-2020-05/R001, F00007, Administratorja, *Njoftim për Caktimin e Mbrojtësit Kujdestar për Salih Mustafën*, 29 janar 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

¹³ KSC-BC-2020-06, F02112, Trupi Gjykues II, [*Decision on Defence Counsel Request for Determination Pursuant to Article 28\(4\)\(b\)\(i\) of the Code of Professional Conduct for Counsel and Prosecutors \(Conflict of Interest\)*](#), (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtëses për Vendim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët (Konflikt Interesash)), 8 shkurt 2024, publik, para 36(a).

¹⁴ KSC-BD-15, Administratorja, *Udhëzues Pune i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 17 maj 2019, publik.

¹⁵ *Shih* para. 7 më lart.

B. AFATI I PARASHTRIMEVE LIDHUR ME KËRKESËN E MBROJTËSES SË VIKTIMAVE

12. Gjykatësi i Vetëm vëren se Mbrojtja nuk ka dorëzuar përgjigje për Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave. Duke mbajtur parasysh sa më lart dhe ndryshimin e mbrojtësve,¹⁶ si dhe për të garantuar të drejtat e z. Mustafa, Gjykatësi i Vetëm vendos të zgjasë *proprio motu* afatin e Mbrojtjes për t'iu përgjigjur Kërkesës së Mbrojtëses së Viktimave, në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores. Mbrojtja, nëse dëshiron, mund të përgjigjet brenda dhjetë (10) ditësh nga dorëzimi i këtij vendimi. Mbrojtësja e viktimave, nëse dëshiron, mund të kundërpërgjigjet në bazë të rregullës 76 të Rregullores.

C. DOKUMENTACIONI I ÇËSHTJES DHE TRANSFERIMI I PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA

13. Gjykatësi i Vetëm vëren se të gjitha parashtrimet e protokolluara lidhur me këtë proces janë regjistruar në dokumentacionin e çështjes KSC-CA-2023-02 ose KSC-CA-2023-02/R, që i përket Dhomës së Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykatësi i Vetëm rikujton se: (a) procesi aktual ka lidhje me vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim, që u lëshua nga Trupi Gjykues I dhe u protokollua në dokumentacionin e çështjes KSC-BC-2020-05, që i përket Dhomës së Gjykatës Themelore; dhe (b) Urdhri për Zhdëmtim nuk është apeluar dhe Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit i ka konfirmuar të gjitha vendimet që përbëjnë bazën e Urdhrit për Zhdëmtim.¹⁷ Gjykatësi i Vetëm vlerëson se, në mënyrë që të pasqyrohet sa më saktë konteksti dhe zhvillimi i procesit aktual, është më e përshtatshme të regjistrohet i gjithë dokumentacioni lidhur me këtë proces në dokumentacionin e çështjes KSC-BC-2020-05, të shënuar me

¹⁶ *Shih* para. 8 më lart.

¹⁷ KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Appeal Judgment](#), (Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit), 14 dhjetor 2023, para. 481.

shkurtesën e dytë “R”, siç parashihet në nenin 21(2) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm vendos që procesi aktual lidhur me vënien në jetë dhe zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim do të vijojë në dokumentacionin e çështjes KSC-BC-2020-05/R.

14. Bazuar në sa më sipër, Gjykatësi i Vetëm urdhëron Administratoren të transferojë dokumentet vijuese nga dosja e çështjes KSC-CA-2023-02 ose KSC-CA-2023-02/R në dosjen e çështjes KSC-BC-2020-05/R, sipas radhës së mëposhtme:

- KSC-CA-2023-02, F00025, 31 maj 2023, bashkë me shtojcat;
- KSC-CA-2023-02/R, R001/F00001, 17 janar 2024;
- KSC-CA-2023-02/R, R001/F00002, 19 janar 2024;
- KSC-CA-2023-02/R, R001/F00003, 22 janar 2024;
- KSC-CA-2023-02/R, R001/F00004, 23 janar 2024;
- KSC-CA-2023-02/R, R001/F00005, 24 janar 2024, përfshirë versionin e redaktuar konfidencial;
- KSC-CA-2023-02/R, R001/F00006, 29 janar 2024, bashkë me shtojcën; dhe
- ky vendim.

15. Pas dorëzimit të këtij vendimi, dosja KSC-CA-2023-02/R do të mbyllet. Të gjithë dokumentet në të do të ruajnë nivelin aktual të klasifikimit. Dokumentacioni i ri (parashtrime të protokolluara, transkripti, provat, korrespondenca etj.) do të dorëzohen në dokumentacionin e çështjes KSC-BC-2020-05/R.

IV. VENDIM

16. Për arsyet e përmendura më sipër, Gjykatësi i Vetëm:

- a. **RRËZON** Kërkesën e Mbrojtjes *in limine*.

- b. **URDHËRON** Mbrojtjen t'i përgjigjet Kërkesës së Mbrojtëses së Viktimave, nëse dëshiron, brenda dhjetë **(10) ditësh** nga njoftimi i këtij vendimi dhe **URDHËRON** Mbrojtësen e Viktimave, të kundërpërgjigjet, nëse dëshiron, **brenda pesë (5) ditësh** nga përgjigjja, nëse ka;
- c. **URDHËRON** Administratoren, palët dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të respektojnë urdhrat e Gjykatësit të Vetëm në paragrafët 13-15 të këtij vendimi; dhe
- d. **URDHËRON** Mbrojtësen e Viktimave të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës së Mbrojtjes së Viktimave (parashtrimi F00002), ose të kërkojë riklasifikimin e tij deri **të premtën, 23 shkurt 2024**.

/nënshkrimi/
Gjykatës Zhilber Biti
Gjykatës i Vetëm

E martë, 20 shkurt 2024

Në Hagë, Holandë